

**TERMAT E REFERENCES DHE QELLIMI PER SHERBIMIN PER  
EKSPERTIN LIGJOR NE PROJEKTIN "Return Roses for a  
Sustainable Environment and Tourism"**

Qellimi	<b>Ekspert Ligjor</b> ne Projektin: " <i>Return Roses for a Sustainable Environment and Tourism</i> " i mbeshtetur nga donatoret BASHKIA PERMET NE PARTNERITET ME PROGRAMIN ReLOaD
Kohezgjatja e sherbimit	20.10.2018 -31.01.2019 18 dite ne total
Data e fillimit	Menjehere pas nenshkrimit te kontrates
Raportontek	Menaxherit te Projektit te SDC
Afati i fundit per aplikim	17.10.2018
Dokumentet e nevojshem per aplikim	Leter interesi, CV. Referenca nga punedhensesit e meparshem

**1: PREZANTIM I PROJEKTIT**

**Pershkrim i shkurter**

Aktualisht, Qendra e Studimeve dhe Zhvillimeve po zbaton projektin "Return Roses for a Sustainable Environment and Tourism"i cili u miratua nga Programi ReLOaD, i cili eshte nje iniciative rajonale, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Programi i Kombeve te Bashkuara per Zhvillim ne 6 territore te Ballkanit Perendimor, perfshire Shqiperine. Aktivitetet e projektit do te zbatohen gjate periudhes: Shtator 2018 - Maj 2019 ne zonen e Permetit

Objektivi i pergjithshem i ketij projekti eshte perforcimi i identitetit natyror dhe turistik te qytetit, duke qene miqesor me mjedisin, duke permiresuar dhe rritur njohurite, mundesite dhe stimujt per zhvillimin e turizmit ne kater stine.

Permes ketij projekti QSZH synon te ruaje trashegimine natyrore dhe krijimin e markes: "Qyteti i trendafilave", nepermjet zhvillimit te mjedisit, duke perfshire turizmin. Qellimi yne eshte qe te inkurajojme zhvillimin e qendrueshem te turizmit duke ulur ndikimin negativ ne mjedis, duke



Ky projekt financohet nga  
Bashkimi Evropian



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET



Empowered lives.  
Resilient nations.

*Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga  
Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*

siguruar qendrushmeri afatgjate, me sa me shume investime qe te jete e mundur per zhvillimin e turizmit.

## **2. ZONAT DHE GRUPET E SYNUARA**

- 1-20 te rinj , 10 femra dhe 10 meshkuj shkolla nentevjecare “Meleq Gosnishti”
- 2- 6 biznese lokale, 3 femra dhe 3 meshkuj nga zona Permetit
- 3- 14 Fermere, 7 femra dhe 7 meshkuj nga zona e Permetit

Perfituesit direkt do te jene te gjithë individët,bizneset, fermeret dhe institucionet te cilat e kane fokusuar aktivitetin e tyre ne industrine e turizmit .

Komuniteti do te perfitoje ne menyre indirekte ,nga rritja e turizmit local dhe potencialit ekonomik.

## **3. REZULTATET E PRITURA**

Ne fund te kontrates Eksperti Ligjor duhet te kete arritur te:

1. Rritjen e ndergjegjesimit dhe informimin e grupeve te synuara
2. Trajnimin e focus grupeve rreth legjislacionit mjedisor.
3. Rritje e ndergjegjesimit dhe perfshirje e komunitetit ne lidhje me te mirat qe sjell njohja dhe zbatimimi i ligjit

## **4. DETYRAT**

Eksperti Ligjor pritet te kryeje detyrat e meposhtme:

- Pergatitjen e moduleve mjedisore deri ne fund te muajit Tetor, si dhe shumfishimin e 50 moduleve te cilat do te shperndahen tek focus grupet dhe donatoret.
- Te zhvilloje nje takim trajnues me te rinjte e shkolles nentevjecare.
- Te zhvilloje nje takim trajnues me bizneset lokale ne qytetin e Permetit
- Te zhvilloje nje takim trajnues me fermeret ne zonen e Permetit
- Pergatitje e raportit final pas takimeve trajnuese.

## **5. KUALIFIKIMET**

Te gjithë individët e interesuar duhet te dergojne nje leter interesi se bashku me CV e tyre dhe referencat. Eksperti duhet te kete kualifikimet e meposhtme:



Ky projekt financohet nga  
Bashkimi Evropian



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E PËRMET



Empowered lives.  
Resilient nations.

*Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*

- Diplome Universitare ne universitetin e Drejtesise.
- Diploma apo specializime te tjera universitare apo pasuniversitare ne Agronomi, Inxhinieri Mjedisi, Inxhinieri Pyjesh, apo fusha te tjera lidhur me mjedisin do te konsiderohen nje avantazh.
- Mbi 5 vjet experience ne fushen e ligjit apo legjislacionit mjedisor
- Perfshire ne trajnime/ projekte me focus mjedisin dhe legjislacionin mjedisor
- Aftesi te shkelqyera ne komunikim si dhe aftesi per te punuar me grupe te ndryshme gjate seancave te trajnimit.
- Njohuri rreth legjislacionit europian te mjedisit, do te konsideroheshin nje avantazh.
- Njohuri e mire e gjuhes Angleze do te konsiderohej nje avantazh.

## **6. KOHEZGJATJA**

Detyra do te zhvillohet gjate periudhes 20.10.2018 deri ne 31.01.2019. Gjithsej 18 dite

## **7. PAGESA**

Pagesa per ekspertin/eksperten e perzgjedhur do te kryhen ne perfundim te te gjitha detyrave sa me siper (pika nr. 4). Ne rast se palet bien darkort mund te bien dakort per pagesa me disa transhe duke i lidhur ato me detyra te perfunduara.

## **8. APLIKIMI**

Dokumentacioni i kerkuar duhet te dorezohet ne adresat e meposhtme nepermjet postes ose adreses se emailit.

**Studies and Development Center (SDC)**

**Rr.GjinBueShpata, p.AviacioniVjeter, shk. 6 ap. 29.**

**Tirane**

**Email: [info@sdc.org.al](mailto:info@sdc.org.al)**

**Web: [www.sdc.org.al](http://www.sdc.org.al)**

- ❖ **Gjate procesit te seleksionimit do te kene prioritet te gjithe aplikuesit nga zona e Permetit.**



Ky projekt financohet nga  
Bashkimi Evropian



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PËRMET



Empowered lives.  
Resilient nations.

*Programi Rajonal mbi Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – ReLOaD financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Proarami i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).*